

Të Drejtat e Fëmijëve në Legjislacionin Shqiptar

Msc Marjeta Gjellaj

Fakulteti i Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale

Kolegji Universitar i Biznesit

Abstrakt:

Ky punim trajton aspektet më të spikatura të legjislacionit shqiptar për të drejtat e fëmijëve, me qëllim që t'i shërbejë njohjes dhe respektimit të tyre. Informacioni që paraqitet ka në vëmendje të veçantë, prindërit e fëmijët, të rinjtë, nxënësit e studentët, punonjës të autoriteteve etj, të cilët janë të gjithë subjekte që kanë nevojë të njohin të drejtat e fëmijëve dhe t'i ushtrojnë ato, në kuadrin e gëzimit të të drejtave të njeriut. Njohja e të drejtave të fëmijëve shërben për punonjësit e organeve të pushtetit qendror e vendor, si dhe të të gjitha enteve publike, të cilët kryejnë detyrat e tyre në fusha të ndryshme që lidhen me ushtrimin e të drejtave të fëmijës. Detyrimi i tyre për të respektuar të drejtat dhe liritë themelore është vendosur shprehimisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

“Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”.

Të drejtat e fëmijëve janë pjesë e pandarë e të drejtave dhe lirive të njeriut. Këto të fundit, përfaqësojnë të drejta që kanë epërsi, në raport me të drejtën pozitive të shtetit, pra me aktet normative që dalin në shtet. Të gjitha ligjet hartohen në bazë e për zbatim të tyre. Prandaj është e domosdoshme që ato të njihen, të kuptohen mirë dhe të përmbushen në mënyrën më të dobishme, nga ana e institucioneve shtetërore. Të drejtat për fëmijët, si pjesë e të drejtave të njeriut i gjejnë të vendosura në Kushtetutën tonë, si dhe në aktet ndërkombëtare të ratifikuara. Ligjet e brendshme të vendit janë shumë të rëndësishme, pasi rregullojnë këto të drejta në bazë e për zbatim të këtyre akteve.

Kushtetuta e Shqipërisë sanksionon: “Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. Fëmijët e lindur jashtë martesë kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesë. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal.

Një nga parimet kryesore të ligjit “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, është: Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën, çka nënkupton:

Të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën.

Fjalë kyçe: Fëmijë, Të drejta, Interes i lartë, Autoritete shtetërore

Hyrje

Të drejtat e fëmijëve janë të drejta të njeriut. Çdo fëmijë në Shqipëri dhe në të gjithë botën duhet të gëzojnë të njëjtat të drejta dhe të jenë në gjendje të jetojnë pa diskriminim, të mbrojtur nga të gjitha format e dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit. Të drejtat njerëzore të fëmijëve dhe standardet për të cilat duhet të aspirojnë të gjitha qeveritë në realizimin e këtyre të drejtave për të gjithë fëmijët, janë më konçize dhe plotësisht të artikuluar në një traktat ndërkombëtar për të drejtat e njeriut: në Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Konventa është instrumenti më i pranuar, në nivel botëror, i të drejtave të njeriut në histori. Konventa njeh të drejtën e të gjithë fëmijëve për të pasur fillimin më të mirë të mundshëm në jetë, për t'u rritur të lumtur dhe të shëndetshëm dhe për të zhvilluar potencialin e tyre të plotë. Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën. Kjo përfshin të drejtën për të jetuar në një planet të pastër dhe të shëndetshëm, në një mjedis mbrojtës, për t'u çlodhur, për të luajtur dhe për të shijuar veprimtari kulturore dhe artistike dhe për të shijuar dhe respektuar mjedisin natyror. Familjet dhe komunitetet gjithashtu duhet të sigurohen me mbështetjen e nevojshme, në mënyrë që ata të mund t'iu sigurojnë fëmijëve mirëqenien dhe zhvillimin. Konventa është ratifikuar nga më shumë vende në botë se çdo traktat tjetër ndërkombëtar dhe ky fakt në mënyrë unike, i vendos fëmijët në qendër të skenës, në përpjekjet për zbatimin universal të të drejtave të njeriut. Duke ratifikuar këtë instrument, qeveritë kombëtare janë angazhuar për mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të fëmijëve dhe kanë rënë dakord për të mbajtur përgjegjësi para bashkësisë ndërkombëtare për këtë angazhim. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara me 20 Nëntor 1989, është një nga aktet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare në të cilën janë parashikuar të drejtat dhe detyrimet në të gjitha fushat e jetës së fëmijës, të grumbulluara në një mënyrë kaq të plotë dhe të detajuar si në asnjë akt tjetër juridik në fushën e të drejtave të fëmijëve.

Në Kushtetutën shqiptare (neni 122) thuhet se çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik, pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Kjo dispozitë e Kushtetutës ka rëndësi të veçantë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, sepse edhe në rastet kur në legjislacionin e brendshëm ka mangësi mund të zbatohet direkt Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës. Konventa për të Drejtat e Fëmijës u ratifikua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në Shkurt 1992 dhe hyri në fuqi në Mars 1992. Të drejtat e fëmijës dhe ato të njeriut në përgjithësi në Shqipëri kanë pësuar përmirësime të ndjeshme me anë të reformave të gjithanshme ligjore dhe institucionale, duke u afruar me standartet Europiane. Në muajin Maj 2008 Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB), ka ndërmarrë inisiativën për hartimin e ligjit kuadër "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës". Qëllimet e këtij ligji janë miratimi dhe zbatimi i politikave ekzistuese që ndikojnë mbi të drejtat e fëmijëve, duke i përshtatur ato me standartet ndërkombëtare, si dhe vendosjen e një sistemi efektiv monitorimi lidhur me garantimin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve në nivel qendror dhe vendor.

Shqipëria ka raportuar në mënyrë periodike për zbatimin e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Nisur nga rekomandimet e lëshurara për vendin tonë në mënyrë të vazhdueshme, në vitin 2017 u miratua ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, i cili shfuqizoi ligjin e mëparshëm duke sanksionuar të drejtat dhe mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat dhe autoritetet përgjegjëse, që garantojnë me efektivitet ushtrimin, respektimin, promovimin e këtyre të drejtave, si dhe mbrojtjen e veçantë të fëmijës si dhe u miratua për herë të parë Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili sanksionoi për herë të parë rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

Si u krijuan të drejtat e fëmijëve?

Pas Luftës së Dytë Botërore, shumë kombe në botë formuan një bashkim, ato themeluan OKB-në, që është Organizata e Kombeve të Bashkuara. Së bashku ato donin të mbështetnin paqen dhe lirinë në botë. Me 10 Dhjetor 1948, Kombet e Bashkuara miratuan Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut. Këto të drejta themelore të të gjitha qenieve njerëzore në botë zbatoheshin edhe për fëmijët. Por shpejt u sugjerua se fëmijët ishin diçka e veçantë dhe për këtë arsye ata kishin nevojë për mbrojtje të veçantë. Në vitin 1950 u ndërtua një draft i parë i të drejtave të fëmijëve. Për disa vite, përfaqësuesit e shteteve anëtare e diskutuan atë në Kombet e Bashkuara. Më 20 Nëntor 1959, Kombet e Bashkuara miratuan Deklaratën e të Drejtave të Fëmijës. Një deklaratë e tillë nuk është e detyrueshme për të gjitha shtetet, por ajo ka avantazhin se u drejtohet të gjitha shteteve si një rekomandim për politikën e tyre të ardhshme. Viti 1979 në të gjithë botën, u festua si Viti i Fëmijës. Të drejtat e fëmijëve u menduan dhe u diskutuan kudo. Gjithnjë e më shumë njerëz dëshironin që këto të drejta të përpunoheshin më në detaje për të mirën e fëmijëve dhe, ajo që ishte më e rëndësishme, të bëheshin ligjërishit më detyruese. Më 20 Nëntor 1989 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi unanimisht Konventën për të Drejtat e Fëmijës ose siç quhet Marrëveshja për të Drejtat e Fëmijëve. Që atëherë, pothuajse të gjitha qeveritë e kombeve të botës e kanë nënshkruar këtë konventë për të drejtat e fëmijëve. Duke vepruar kështu, ata premtojnë të përhapin informacion për të drejtat e fëmijëve në vendet e tyre, për t'i zbatuar ato dhe për t'i dhënë vëmendje të veçantë mbrojtjes së fëmijëve. Por ende, në shumë vende të botës, fëmijët vuajnë padrejtësi serioze Secili prej nesh është përgjegjës dhe duhet të ndërmarrë veprime, në qoftë se duam që të gjithë fëmijët në botë të gëzojnë të drejtat e tyre.

I. Të drejtat e fëmijëve në Shqipëri.

Ligji i ri për të Drejtat e Fëmijës në Shqipëri trajton pjesën më të madhe të sfidave serioze me të cilat përballen fëmijët në vendin tonë dhe e njeh fëmijën si mbajtës i të drejtave dhe përcakton që prindërit, qeveria dhe shoqëria të kenë përgjegjësi të përbashkët për t'u kujdesur dhe për të mbrojtur çdo fëmijë. Çdo e drejtë e deklaruar e fëmijëve tashmë përkon me detyrime të veçanta të autoriteteve publike, që do ta bëjnë më efikas zbatimin, si dhe monitorimin e detyrimeve përkatëse. Ky ligj promovon interesin më të lartë të fëmijës, sanksionon të drejtat themelore të fëmijëve sic janë:

Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare

e sociale të përshtatshme për fëmijën. Në zbatimin e këtij parimi mbahen parasysh: nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri si dhe rritjen/përkatësinë në një familje; mendimi i fëmijës, në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar; historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen; aftësia e prindërve ose personave që kujdesen për mirërritjen e fëmijës për t'iu përgjigjur nevojave të fëmijës; vazhdimësia e marrëdhënieve personale ndërmjet fëmijës dhe personave, me të cilët ai ka lidhje gjinore, shoqërore ose shpirtërore.

E drejta për të pasur një emër, shtetësi, për të njohur prindërit dhe ruajtur identitetin. Në përputhje me ligjin në fuqi, fëmija ka të drejtë: të regjistrohet falas, menjëherë me lindjen e tij. Këtë të drejtë e kanë edhe fëmijët e lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me kërkesë të prindit ose kujdestarit, të ketë një emër; të fitojë shtetësinë; të njohë prindërit dhe të gëzojë përkujdesin e prindërve, aq sa është e mundur. Në rast se një fëmijë është privuar në mënyrë të paligjshme nga një ose disa elemente të identitetit të tij, atij i sigurohet ndihma e përshtatshme për ta rikthyer në identitet, përfshirë edhe garantimin e përkujdesjes së institucioneve shtetërore, për t'i dhënë mundësinë që të praktikojë fenë, kulturën dhe gjuhën e origjinës. Ndihe mund të përfshijë dhënien e informacionit gjenetik për gjetjen e prindërve, gjetjen e të afërmeve ose të familjarëve të fëmijës, refugjatë e azilkërkues, me qëllim bashkimin familjar.

E drejta për të qëndruar me prindërit. Fëmija ka të drejtë të qëndrojë me prindërit dhe të mos ndahet kundër dëshirës së tyre, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos që kjo ndarje është në interesin më të lartë të fëmijës. Pamundësia ekonomike nuk është shkak i mjaftueshëm që autoritetet shtetërore të vendosin ndarjen e fëmijës nga familja ose të afërmit me të cilët jeton, apo të heqjes së përgjegjësisë prindërore. Fëmija, në çdo rast, ka të drejtë të dëgjohet dhe t'i merret mendimi ose pëlqimi nga gjykata, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Fëmija i ndarë nga njëri ose nga të dy prindërit ka të drejtë të kalojë kohë ose të mbajë marrëdhënie vetjake të rregullta dhe të ketë takime të drejtpërdrejta me ta, me përjashtim të rasteve kur gjykata vendos se është në kundërshtim me interesin më të lartë të tij.

Prindi ose kujdestari nuk mund ta ndalojë fëmijën për të mbajtur marrëdhënie vetjake me të afërmit, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos ndryshe, për shkaqe që dëmtojnë zhvillimin fizik, psikologjik ose moral të fëmijës. Në rastet kur ka mosmarrëveshje ndërmjet prindërve, lidhur me mënyrat e ushtrimit të të drejtave të tyre për të mbajtur kontakte me fëmijën, gjykata vendos një ditar të përcaktuar me orare, sipas moshës së fëmijës, intensitetit të lidhjes emocionale që fëmija ka me prindin, me të cilin nuk bashkëjeton, sjelljen e këtij të fundit, si dhe aspekte të tjera të rëndësishme për vendimmarrjen e gjykatës në secilin rast.

E drejta për ribashkim familjar. Fëmija ka të drejtë të kërkojë për të hyrë ose për t'u larguar nga Republika e Shqipërisë për arsye të ribashkimit familjar me prindërit e tij. Kjo kërkesë trajtohet në një frymë pozitive, njerëzore e të shpejtë dhe refuzohet vetëm në rastin kur ka arsye për të dyshuar se hyrja ose largimi nuk është në interesin më të lartë të fëmijës.

E drejta për t'u zhvendosur nga vendbanimi ose për të siguruar kthimin në vendin e origjinës. Zhvendosja e fëmijës brenda ose jashtë vendit bëhet me marrëveshjen e të dy prindërve ose, në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet tyre, me vendim gjykate, pasi të jetë marrë mendimi ose pëlqimi i fëmijës. Mendimi ose pëlqimi i fëmijës merret në konsideratë për çështje që lidhen me kthimin e tij në vendin e origjinës, në përputhje me moshën dhe

aftësinë e tij për të kuptuar. Me qëllim që fëmija të shprehë mendimin e tij, atij i ofrohet informacion i plotë lidhur me situatën e përgjithshme sociale, ekonomike, si dhe shërbimet që mund t'i ofrohen në vendin e origjinës.

Liria e shprehjes. Çdo fëmijë ka të drejtë të shprehë lirisht, individualisht dhe kolektivisht pikëpamjet dhe mendimin e tij për çdo çështje që ka të bëjë me të drejtpërsëdrejti ose me familjen e tij apo komunitetin, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Fëmija ka të drejtë të kërkojë, të marrë dhe të përcjellë informacione e ide të çdo lloji, në çdo formë ose me çdo mjet të zgjedhur nga ai, me përjashtim të rasteve kur cenohet një interes publik, siguria kombëtare ose nderi e dinjiteti apo të drejtat e të tjerëve.

E drejta për t'u dëgjuar. Fëmijës i garantohet e drejta për t'u dëgjuar vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit në të gjitha proceset administrative e gjyqësore që lidhen me të, sipas rregullave procedurale për këtë qëllim. Nëse autoritetet refuzojnë të marrin mendimin e fëmijës, në çdo rast duhet dhënë vendim i arsyetuar për shkaqet e refuzimit. E drejta e fëmijës për t'u dëgjuar respektohet nga autoritetet shtetërore gjatë proceseve vendimmarrëse që lidhen me hartimin e zbatimin e politikave për të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen e tyre. Fëmija, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, ka të drejtë të ankohet vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit të tij kundër vendimeve apo masave të marra nga autoritetet shtetërore lidhur me të. Kur fëmija e ushtron vetë këtë të drejtë, punonjësit e administratës së shërbimit civil ose të administratës gjyqësore kanë detyrimin t'i japin këshillimin e nevojshëm.

E drejta e informimit. Fëmija ka të drejtë të kërkojë ose të marrë çdo lloj informacioni në lidhje me mirëqenien, edukimin dhe zhvillimin e tij fizik e psikologjik. Fëmija ka të drejtë të aksesohet me të gjithë regjistrat ku mbahen të dhëna për të.

Liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore. Fëmijës i garantohet liria e organizimit dhe e tubimeve paqësore. Ndalohet detyrimi i fëmijës për tubim në kundërshtim me vullnetin e tij. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës pranë organeve të vetëqeverisjes vendore, institucionet arsimore dhe çdo institucion tjetër publik apo privat mbikëqyrin nëse kjo e drejtë garantohet nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit për të drejtat e fëmijës dhe në rast mosrespektimi, njoftojnë organet e policisë për marrjen e masave konkrete, duke mbajtur në vëmendje sigurinë e fëmijës gjatë ushtrimit të kësaj të drejte. Mosrespektimi i këtij detyrimi përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë.

Liria e jetës private. Fëmijës i garantohet respektimi i jetës private, familjare, banesës, korrespondencës dhe mbrojtja nga cenimi i paligjshëm i moralit dhe i dinjitetit të tij. Privatësia e fëmijës mbrohet në të gjitha situatat, përfshirë ato brenda familjes, institucioneve të kujdesit shëndetësor, shoqëror e të shërbimeve. Kjo e drejtë përfshin privatësinë e marrëdhënieve e të komunikimeve me të tjerët, të drejtën për këshillim konfidencial, kontrollin e aksesit në informacionin që ruhet për fëmijët në dosjet përkatëse. Privatësia e fëmijës respektohet në të gjitha fazat e procedurave gjyqësore apo administrative, duke përfshirë edhe publikimin e tyre në media. Pjesëmarrja e fëmijës nën moshën 14 vjeç në debate publike, si dhe në programe audiovizive bëhet vetëm me miratimin e prindit ose kujdestarit të fëmijës. Fëmijët nuk mund të përdoren apo të ekspozohen nga prindi, kujdestari, institucionet publike apo private për qëllime të përfitimit personal apo për të ndikuar vendimet e autoriteteve publike. Transmetuesit audiovizivë mbajnë përgjegjësi për rastet e mosrespektimit të lirive dhe të drejtave të fëmijës gjatë transmetimit të programeve të tyre, në përputhje me ligjin për të drejtat e fëmijës, si dhe me legjislacionin për mediat audiovizive.

E drejta për arsimim. Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm. Në këto raste prindi ose kujdestari merr masa të përshtatshme që fëmija të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose nivele të tjera të arsimimit, sipas dëshirës së fëmijës, si dhe të garantojë frekuentimin e rregullt të tij dhe pa pengesa.

E drejta për pushim dhe argëtime kulturore e sportive. Fëmija ka të drejtë të pushojë, të argëtohet, të praktikojë lojëra dhe veprimtari çlodhëse dhe të marrë pjesë lirisht në jetën kulturore, artistike e sportive, në përshtatje me moshën e tij. Autoritetet publike qendrore e vendore, brenda kompetencave të tyre, marrin masa konkrete për krijimin e kushteve të përshtatshme dhe mundësive të barabarta për ushtrimin e aktiviteteve kulturore, artistike e çlodhëse për të gjithë fëmijët, duke garantuar akses të sigurt në mjedise sportive, kënde lojërash ose mjedise të tjera çlodhëse për të gjithë fëmijët, pavarësisht moshës, gjinisë, racës, etnisë, aftësisë ose kushteve sociale ekonomike me qëllim mbrojtjen e fëmijës nga dëmtimet e mundshme të shëndetit, krijimin e hapësirave të përshtatshme për të mundësuar ushtrimin e sigurt dhe gjithëpërfshirës të veprimtarive sportive, kulturore e dëfryese në mjediset shkollore dhe komunitare.

E drejta për nivel jetese të përshtatshëm. Fëmija ka të drejtë të gëzojë një nivel jetese të përshtatshëm për zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror. Prindi ose kujdestari kanë detyrimin dhe përgjegjësinë parësore për t'i siguruar, brenda aftësive dhe mundësive financiare që ata kanë, kushtet më të mira të jetesës, të nevojshme për rritjen dhe zhvillimin e fëmijës. Çdo fëmijë gëzon të drejtën e aksesit në programe për zhvillimin e fëmijërisë së hershme, duke përfshirë aksesin në çerdhe, kopshte ose programe të tjera zhvillimi, si dhe të drejtën e ushqimit gjatë ndjekjes së këtyre programeve, sipas standardeve të parashikuara në akte nënligjore.

E drejta për kujdes shëndetësor. Fëmijës i garantohet e drejta për kujdes shëndetësor falas dhe e standardit më të lartë, si dhe përfitimi nga shërbimet për trajtimin e sëmundjes e për riaftësimin e shëndetit. Kjo e drejtë nuk mund të kufizohet, pavarësisht nëse fëmija është i regjistruar ose jo në regjistrin e gjendjes civile ose nëse prindërit e fëmijës kanë paguar ose jo taksat. Garantimi i kësaj të drejte bëhet nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë, e cila merr masa për të ulur vdekshmërinë foshnjore dhe fëmijërore, për t'u siguruar të gjithë fëmijëve kujdesin shëndetësor falas e cilësor, për të luftuar sëmundjen dhe kequshqyerjen, edhe në kuadrin e kujdesit shëndetësor parësor, me anë të sigurimit, ndër të tjera, të produkteve ushqimore të përshtatshme dhe të ujit të pijshëm të pastër, duke pasur parasysh rreziqet e ndotjes së mjedisit natyror;

E drejta për të përfituar nga shërbimi i kujdesit shoqëror. Fëmija ka të drejtë të përfitojë nga shërbimi i kujdesit shoqëror, drejtpërdrejt apo nëpërmjet prindit ose kujdestarit të tij, Në rast se prindi/prindërit ose personi/ personat që kujdesen për fëmijën nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, për shkaqe që nuk varen prej vullnetit të tyre, nevojat minimale të fëmijës për strehim, ushqim, veshmbathje dhe edukim, ofrohen nga shteti, kur kjo kërkohet prej tyre.

Mbrojtja nga të gjitha format e dhunës. Fëmija ka të drejtë të mbrohet ndaj të gjitha formave të dhunës, duke përfshirë abuzimin, neglizhimin, shfrytëzimin, trafikimin, pengmarrjen, pornografinë, abuzimin seksual, si dhe forma të tjera të dhunës, pavarësisht vendit ku kryhet. Fëmija mbrohet edhe nga të gjitha format e migracionit të paligjshëm. Prindërit e fëmijës ose kujdestari, në bashkëpunim me institucionet e kujdesit shëndetësor,

të edukimit, strukturat e mbrojtjes së fëmijës dhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror marrin të gjitha masat e nevojshme për të bërë të mundur rehabilitimin fizik, psikologjik e emocional, si dhe integrimin social të fëmijës viktimë e dhunës, neglizhimit, shfrytëzimit ose abuzimit, sipas legjislacionit në fuqi. Është i ndaluar ndëshkimi trupor ose i ndonjë forme tjetër, që sjell pasoja në zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijës.

Mbrojtja nga shfrytëzimi ekonomik. Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, i cili përfshin kryerjen e çdo pune që paraqet rreziqe për shëndetin fizik dhe mendor, mirëqenien e zhvillimin e tij tërësor, cenon edukimin. Fëmijët nën moshën 16 vjeç mund të kryejnë punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin, formimin e tij ose e largojnë atë nga shkolla.

Mbrojtja nga përdorimi i alkoolit, duhanit, substancave narkotike dhe i lëndëve psikotrope. Fëmija duhet të mbrohet nga përdorimi i alkoolit, duhanit, substancave narkotike dhe i lëndëve psikotrope; autoritetet brenda kompetencave, marrin masa, me qëllim: a) parandalimin e përfshirjes së fëmijës në prodhimin, shpërndarjen dhe trafikimin e substancave narkotike; b) rritjen e ndërgjegjësimin publik dhe të fëmijës për këtë çështje, përfshirë edhe hartimin e kurrikulave të nevojshme për këtë qëllim; c) përkrahjen e fëmijës dhe familjeve të tyre nëpërmjet këshillimit; ç) hartimin e politikave, strategjive dhe shërbimeve që garantojnë rehabilitimin fizik, mendor dhe social të fëmijës që përdor alkool, duhan ose substanca narkotike e psikotrope. 4. Strukturat e mbrojtjes së fëmijës në njësinë e qeverisjes vendore mbështesin fëmijën dhe familjen nëpërmjet referimit të çështjes te shërbimet e specializuara për këtë qëllim.

Mbrojtja e fëmijës nga aksesin në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet. Zhvillimi i teknologjisë së sotme paraqet nevojën që prindi, kujdestari ose çdo person tjetër, i cili është në kontakt me fëmijën ta mbrojë atë nga aksesin në materiale me përmbajtje të dëmshme ose të paligjshme në internet. Autoritetet publike/private, që ofrojnë akses në internet, duhet të aplikojnë instrumente teknike dhe masa të tjera për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesin në internet.

Mbrojtja nga trafikimi dhe çdo lloj forme e shfrytëzimit dhe abuzimit seksual. Fëmija duhet mbrojtur nga trafikimi, shitja dhe çdo formë e shfrytëzimit dhe e abuzimit seksual, duke përfshirë veprimtarinë e paligjshme seksuale, shfrytëzimin e fëmijës në prostitucion ose në praktika të tjera seksuale të paligjshme, ekspozimi, shfaqja ose përfshirja në materiale pornografike ose abuzimi seksual me fëmijë.

Mbrojtja nga përfshirja në konflikte të armatosura dhe në situata të emergjencave civile. Fëmija nuk duhet të lejohet të përfshihet drejtpërdrejt ose tërthorazi në një konflikt të armatosur. Në rast konflikti të armatosur ose në situata emergjence civile, fëmijës i garantohet një respekt i veçantë dhe mbrojtje nga çdo formë sulmi të paligjshëm. Gjatë konfliktit fëmijës i sigurohet kujdes e ndihmë e veçantë, në përputhje me moshën dhe për çdo arsye tjetër. Nëse fëmija arrestohet ose ndalohet për arsye që lidhen me konfliktin e armatosur, ai mbahet në mjedis të veçanta nga të rriturit, përveç rasteve kur është ndaluar me familjen e tij. Në raste të evakuimit të popullsisë gjatë një konflikti të armatosur ose emergjence civile, fëmijës i jepet prioritet. Drejtoria për Emergjencat Civile dhe njësia për mbrojtjen e fëmijës marrin masat e nevojshme për evakuimin e sigurt të fëmijës. Në çdo rast, fëmija nuk ndahet nga prindërit ose familja e tij.

II. Të drejtat e fëmijëve në drejtësinë penale.

Drejtësia miqësore për të miturit prezumon drejtësi penale për fëmijët, në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe standardet e tjera ndërkombëtare,

mbron interesin më të lartë të tyre. Sipas legjislacionit aktual në fuqi Drejtësia Penale për të Mitur: *"I mitur në konflikt me ligjin"* është çdo person i moshës 14-18 vjeç, ndaj të cilit ekziston një dyshim i arsyeshëm se ka kryer një vepër penale, është marrë si i pandehur dhe/ose është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale. *"I mitur viktimë"* është çdo person nën moshën 18 vjeç, të cilit i është shkaktuar dëm moral, fizik ose material, si pasojë e një veprë penale. Pavarësisht miturisë dhe cilësive të përbashkëta për shkak moshe që i karakterizojnë këto dy subjekte, duhet garantuar një drejtësi penale për të mitur në përputhje me Kushtetutën, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për të Drejtat e Fëmijëve dhe standardet e normat e tjera ndërkombëtare që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit dhe mbrojtjen efektive të interesit më të lartë të të miturit. Për këtë arsye Shqipëria në vitin 2017 pasqyroi të drejtat procedurale penale të fëmijëve, në Kodin e Drejtësisë Penale për të mitur ku sanksionohen të drejtat e mëposhtme:

E drejta për ndihmë juridike dhe psikologjike gjatë një procesi administrativ ose gjyqësor.

Në çdo proces administrativ e gjyqësor, fëmijës i garantohet ndihmë juridike e psikologjike falas, në përputhje me interesat, zhvillimin dhe aftësitë e tij. Ndihma juridike dhe psikologjike ofrohet drejtpërdrejt dhe pa pengesa, bazuar në parimin e mosdiskriminimit dhe të interesit më të lartë të fëmijës. Ndihma juridike përfshin të gjitha veprimet administrative, gjyqësore, si dhe këshillimet që kryen përfaqësuesi, avokati i zgjedhur prej tij ose i caktuar nga autoritetet përgjegjëse gjatë të gjithë procesit administrativ ose gjyqësor. Ndihma psikologjike përfshin të gjitha veprimet, si dhe këshillimet që kryen psikologu i caktuar nga autoritetet përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi. Fëmija, vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit ose përfaqësuesit të tij, bën kërkesë për ndihmë juridike tek institucionet përgjegjëse, të cilat informojnë fëmijën, kujdestarin ose përfaqësuesin e tij për procedurat sipas legjislacionit në fuqi. Gjatë zhvillimit të procedurave administrative e gjyqësore, të dhënat personale të fëmijës dhe jeta e tij private nuk bëhen publike.

Prezumimi i pafajësisë. Çdo i mitur në konflikt me ligjin prezumohet i pafajshëm, derisa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën ndaj të miturit çmohet në favor të tij.

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës. Organet kompetente në çdo vendim dhe veprimtari të ndërmarrë në raport me fëmijën, duhet të vlerësojnë me përparësi interesin më të lartë të të miturit. Në zbatimin e këtij parimi duhen mbajtur parasysh nevojat e fëmijës për zhvillim fizik e psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri, si dhe mendimi i fëmijës në varësi të moshës dhe aftësisë së tij për të kuptuar, historia e fëmijës, dhe nëse ka situata të veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen.

Parimi i mbrojtjes nga diskriminimi. Të drejtat që burojnë nga drejtësia penale (Kodi Penal për të Mitur) i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo të mituri në konflikt me ligjin, viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzania, përkatësia prindërore, përgjegjësi prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, vendbanimi, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje tjetër e të miturit, prindërve ose përfaqësuesve ligjorë të të miturit.

Përparësia e masave alternative të shmangies Për arritjen e qëllimeve të legjislacionit në fuqi që ka lidhje me drejtësinë për të mitur, përparësi u jepet masave alternative të shmangies nga procedimi penal. Masat alternative që synojnë shmangien e të miturit nga

procedimi penal ose zbatimi i masave të drejtësisë restauruese vlerësohen si mundësia e parë. Kur bëhet ky vlerësim, nga çdo organ kompetent, në aktet respektive pasqyrohet mbajtja në vëmendje që masa alternative e shmangies i shërben më mirë qëllimeve të rishoqërizimit, rehabilitimit të të miturit dhe parandalimit të shkeljeve të ligjit përkundrejt vendosjes së tij nën përgjegjësinë penale dhe zbatimit të dënimit penal. Sa herë është e përshtatshme, e mundshme dhe e nevojshme, shmanget vënia në lëvizje e procedurës penale për të miturit në konflikt me ligjin, me kusht që të respektohen plotësisht të drejtat e të miturit dhe mbrojtja e tij. Çdo masë që përdoret ndaj të miturit si alternativë për shmangien nga procedimi penal, duhet t'i shërbejë qëllimit të mbrojtjes së të drejtave dhe garancive ligjore të të miturit.

Kufizimi ose heqja e lirisë si masë e fundit. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një të mituri nuk zbatohet nëse qëllimi mund të realizohet përmes një mase më të butë. Arrestimi, ndalimi ose burgimi i një të mituri zbatohet në përputhje me legjislacionin procedural penal për të mitur.

Parimi i proporcionalitetit. Çdo masë e marrë ndaj të miturit në konflikt me ligjin duhet të jetë në raport me rrethanat e kryerjes së veprës penale, personalitetin e të miturit, në përputhje me nevojat që lidhen me moshën, edukimin, arsimimin kushtet personale, familjare, sociale dhe mjedisore, nevojat zhvillimore, si dhe nevoja të tjera të të miturit përfshirë, nëse është rasti, edhe nevojat e veçanta.

Pjesëmarrja e të miturit në proces. E drejta e pjesëmarrjes në proces përfshin të drejtën e të miturit për t'u dëgjuar dhe për të shprehur pikëpamjet e tij, të cilat mbahen parasysh në përputhje me moshën dhe nivelin e zhvillimit të të miturit. Në rastet kur i mituri kërkon të dëgjohet, kërkesa e tij pranohet, përveçse për arsye të rëndësishme, të cilat arsyetohen në vendimin përkatës. Nëse i mituri nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë, mund ta realizojë atë nëpërmjet prindit si përfaqësues ligjor. I mituri, drejtpërdrejt dhe/ose nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, ka të drejtë të marrë pjesë në çdo proces vendimmarrjeje lidhur me të. I mituri nuk mund të detyrohet të marrë pjesë personalisht në proces. Mospjesëmarrja nuk mund të rëndojë pozitën e tij ose/dhe të përdoret në disfavor të tij. Prokurori dhe gjykata krijojnë të gjitha kushtet dhe marrin çdo masë për të nxitur të miturin për të marrë pjesë në procedimin penal ndaj tij, nëse kjo është në interesin më të lartë të të miturit. Çdo veprim i ndërmarrë nga organet kompetente gjatë procesit ku i mituri është pjesëmarrës, kryhet në mënyrë të përshtatur me moshën dhe/ose aftësitë e të miturit për të kuptuar. Përshtatja dhe mbështetja e nevojshme sigurohet përmes mënyrave të parashikuara në aktet ndërkombëtare të ratifikuara lidhur me personat me aftësi të kufizuara, si dhe në ligjin në fuqi për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara. Në rast se pretendimet e të miturit dhe të përfaqësuesit ligjor/procedural të tij janë kontradiktore, organi kompetent vlerëson pretendimin që i shërben interesit më të lartë të të miturit.

Të drejtat e të miturit në konflikt me ligjin. I mituri në konflikt me ligjin ka të drejtë për mbrojtje dhe procedura të veçanta në të gjitha fazat e procesit të drejtësisë penale për të mitur. Në çdo fazë të procedimit penal, i mituri gëzon të drejtën për ndihmë ligjore dhe psikologjike ose çdo ndihmë tjetër të duhur për përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tij, të drejtën të informohet menjëherë në formën që i përgjigjet zhvillimit individual të tij, të drejtën për një përkthyes falas/interpretues, në qoftë se nuk e kupton, nuk e flet gjuhën që përdoret ose përdor gjuhën e shenjave, të drejtën që të ketë prindin të pranishëm ose një person i besuar, të drejtën të mos detyrohet të dëshmojë ose të pranojë fajësinë, të drejtën që, në kushte të barabarta, të pyesë dëshmitarët e akuzës dhe të sigurojë paraqitjen dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve të mbrojtjes së tij; e) të drejtën për ndihmë nga shërbimi

konsullor, të drejtën për ankim, në çdo fazë të procedimit penal apo gjatë ekzekutimit të vendimit penal. Në lidhje me personin e besuar, gjykata ka të drejtë të mos pranojë një person si të besuar në rast se prania e tij ndikon negativisht në rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturit, por në çdorast gjykata duhet të shprehet me vendim të arsyetuar për shkaqet e mospranimit.

Ndihma ligjore dhe psikologjike e të miturit. Në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur çdo i mitur në konflikt me ligjin ose viktimë ka të drejtë për ndihmë ligjore dhe psikologjike, pa pagesë, të garantuar nga shteti. Kjo ndihmë ofrohet edhe për të miturin që është në cilësinë e dëshmitarit.

Mbrojtja e jetës private të të miturit. E drejta e të miturit për jetë private respektohet plotësisht në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur duke bërë kujdes që të shmanget dëmtimi i tij. Nuk publikohet asnjë informacion që mund të çojë në identifikimin e të miturit në konflikt me ligjin, të të miturit viktimë ose dëshmitar i një veprë penale. Të dhënat mbi dënimet e mëparshme të të miturit nuk bëhen publike. Ndalohet identifikimi ose publikimi në çfarëdolloj forme i të dhënave personale të të miturit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale, të dhënat personale për një veprë penale të kryer nën moshën 18 vjeç mund të identifikohen ose të publikohen vetëm me pëlqimin e tij. Përpunimi i të dhënave të të miturve realizohet në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Vlerësimi individual i të miturit. Në çdo fazë të drejtësisë penale për të mitur, organi që administron procesin e trajton të miturin me kujdes dhe vëmendje të veçantë. Në çdo vendimmarrje në lidhje me të miturin, merren në konsideratë rrethanat individuale të tilla si: moshë, niveli i zhvillimit, kushtet e jetesës, mënyra e rritjes dhe e zhvillimit, edukimi dhe arsimimi, gjendja shëndetësore, gjendja familjare dhe rrethanat e tjera, të cilat lejojnë vlerësimin individual. Gjukata/prokurori, përpara marrjes së ndonjë vendimi mbi të miturin, thërret, sipas rastit, një ekspert ose grup ekspertësh të disiplinave të ndryshme për vlerësimin e rrethanave individuale, shëndetësore, familjare, sociale dhe mjedisore të të miturit në mënyrë që të kuptojë personalitetin, përgjegjshmërinë dhe shkallën e përgjegjësisë së tij. 4. Në qoftë se gjykata/prokurori, pas përfundimit të vlerësimit individual konstaton se i mituri vuan nga çrregullime të shëndetit mendor, që e bëjnë atë të papërgjegjshëm, i mituri përjashtohet nga përgjegjësia penale dhe, nëse është e nevojshme, vendoset në një institucion mjekësor të pavarur dhe të specializuar, sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale

Shërbimet pa pagesë për të miturit në sistemin e drejtësisë penale. Të miturit në konflikt me ligjin ose viktima përfitojnë pa pagesë shërbimet. Pagesat e këtyre shërbimeve mbulohen nga buxheti i institucioneve dhe ekzekutohen nga institucionet përkatëse, pranë të cilave realizohet shërbimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Të drejtat e të miturit viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale. I mituri viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale gëzon, për aq sa është e mundur, të njëjtat të drejta të parashikuara për të miturin në konflikt me ligjin.

III. Të drejtat e fëmijëve për një mjedis të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm

Në Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, që shënohet më 1 qershor, spikatet nevoja për respektimin e të drejtave të tyre. Prandaj realizohen aktivitete të ndryshme, që synojnë promovimin e të drejtave të fëmijëve, dhe ndërgjegjësimin për zbatimin e tyre në jetën e

përditshme. Në këtë aspekt, një vëmendje e veçantë duhet që ti kushtohet edhe të drejtës së fëmijëve për një mjedis të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm.

Hulumtimet dhe publikimet e mekanizmave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara sikurse edhe organizatave jo-qeveritare ndërkombëtare kanë vënë në pah faktin shqetësues se çdo vit më shumë se 1.7 milion fëmijë nën moshën 5 vjeçare humbin jetën si rezultat i degradimit të mjedisit, derisa miliona të tjerë vuajnë nga sëmundje të ndryshme apo dëmtime tjera që mund të kenë efekte afatgjata. Njëkohësisht konsiderojnë se të drejtat e fëmijëve rrezikohen për shkak të masave të pamjaftueshme të qeverive përkatëse për të adresuar çështjet e ndryshimeve klimatike, humbjes së biodiversitetit, eksploatimit të burimeve natyrore, sikurse edhe ekspozimit ndaj substancave toksike dhe mbeturinave, dhe ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës. Për më keq, në një situatë të tillë, fëmijët shpesh herë nuk janë në gjendje që të ushtrorjnë të drejtat e tyre, përfshirë ato për informim, pjesëmarrje dhe qasje efektive në mjetet juridike.

Të drejtat e fëmijëve në raport me mjedisin e shëndetshëm shkelen shumë herë dhe shumë shpesh në jetën e përditshme. Prandaj edhe nevojiten ndryshime fundamentale, në shumë drejtime, në mënyrë që mjedisi i shëndetshëm mos të jetë një gjë luksoze për fëmijët në të ardhmen.

Me rastin e shënimit të 1 qershorit, duhet risjellë në vëmendje faktin se mjedisi i shëndetshëm dhe i qëndrueshëm është parakusht për shëndetin fizik dhe mendor të fëmijëve, sikurse edhe për mirëqenien e tyre, në mënyrë që një ditë ata të bëhen anëtarë të shëndetshëm të shoqërisë. Për këtë arsye është e domosdoshme që të shtohet fokusi sa i përket të drejtave të fëmijëve në raport me mjedisin e shëndetshëm dhe të qëndrueshëm, në mënyrë që organet përgjegjëse të ndërmarin veprime adekuate për përmirësimet e nevojshme në këtë drejtim.

Konventa mbi të drejtat e fëmijës ofron disa pika hyrëse për fuqizimin e të drejtave të fëmijëve në raport me mjedisin. Këto parime janë të instaluar edhe në në legjislacionin tonë. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit bashkë me UNICEF-in në datën 22 nëntor të vitit 2023 në Tiranë nënshkruan Deklaratën për Fëmijët dhe të Rinjtë dhe Veprimet për Klimën. Ky është angazhimi i parë në llojin e tij për të përshpejtuar politikat dhe veprimet klimatike gjithëpërfshirëse, të përqendruara te fëmijët dhe të rinjtë në nivel kombëtar.

Një nga qëllimet e Deklaratës është të zgjerojë pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në proceset e zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike përmes edukimit më të madh rreth ndryshimeve klimatike dhe mjedisit, si dhe përvetësimin të njohurive dhe aftësive të nevojshme për të mbrojtur veten dhe për të kontribuar në një të ardhme të sigurt dhe të qëndrueshme.

"UNICEF është një ndër partnerët tanë më të rëndësishëm sa i takon edukimit të fëmijëve në mënyrë përfshirëse. Sfida është që këtë deklaratë ta përkthejmë në veprimet konkrete të përditshme dhe mesazhet e saj të përthithen nga fëmijët. Jam e bindur se do të kemi një rrugë të bukur, ama tepër sfiduese, që çështjet e

Sipas Indeksit të UNICEF-it mbi risqet e klimës ndaj fëmijëve afërsisht 1 miliard fëmijë (gati gjysma e fëmijëve në botë) jetojnë në vende me rrezik jashtëzakonisht të lartë. Gjithashtu dhe fëmijët në Shqipëri janë në risk të konsiderueshëm të ndryshimeve klimatike. Raporti i Progresit i BE-së i vitit 2023 tregon se Shqipëria ka një nivel përgatitjeje për të trajtuar ndryshimet klimatike, megjithatë duhet bërë akoma më shumë.

Mbrojtja e planetit dhe mbrojtja e fëmijëve shkojnë krah për krah dhe të dyja, mund të arrihen nëse ne veprojmë tani. UNICEF-i në Shqipëri do të vazhdojë të punojë me partnerë

në nivel kombëtar dhe lokal për të siguruar që fëmijët të mund të jetojnë në një mjedis të sigurt dhe të pastër.

REKOMANDIME:

1. Nevojë urgjente për të hartuar një Plan të ri Veprimi, në zbatim të legjislacionit kombëtar të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve për të shmangur një krizë të mundshme të fuqisë punëtore në shërbimet e fëmijëve duke përmirësuar standardin, kualifikimin dhe kapacitetin e profesionistëve të rinj dhe duke mbajtur stafin me përvojë.
2. Duhet të adresohet qasja e ndërtimit të kapaciteteve menaxheriale dhe profesionale dhe llogaridhënies; ngritja e moralit të stafit përmes zhvillimit profesional të vazhdueshëm, të zgjeruar dhe të rregulluar; dhe heqja e barrierave ekzistuese për praktikatat e mira dhe aksesin e plotë në shërbime cilësore.
3. Të shoqërohet përmirësimi i legjislacionit me rritjen e nevojshme të burimeve financiare në nivelin lokal dhe qendror.
4. Të investohet në kapacitete dhe të planifikohen burimet e duhura për të zhvilluar në mënyrë periodike analizë buxhetore me përqendrim te fëmijët, si dhe ngritje kapacitetesh për buxhetimin me qendër fëmijën.
5. Mungesa e analizave të përditësuara të situatës së fëmijëve, kryesisht grupeve më vulnerable.
6. Të përmirësohet koordinimi i strategjive sektoriale kombëtare me planet vendore.
7. Të rritet “E drejta e fëmijëve për t’u dëgjuar”, në çdo proces që zhvillohet për ta.
8. Ekziston nevoja për një kërkim më të përqendruar te fëmija lidhur me dhunën në shtëpi, në shkollë dhe në institucione të tjera.
9. Të trajtohet më vete dhuna online për shkak të veçorive dhe risive që ajo paraqet.
10. Një krijohet një sistem kombëtar elektronik i të dhënave për mbrojtjen e fëmijëve dhe një sistem i unifikuar të dhënash që mbledh informacion mbi fëmijët që janë përfitues të programeve të mbrojtjes sociale në tërësi sepse lehtëson programimin e efektshëm të ndërhyrjeve të qëndrueshme në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.
11. Akoma nuk janë hartuar dhe dakordësuar kriteret mbi trajnimin, liçencimin, kreditimin e specialistëve të ndryshëm në kuadër të zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.
12. Paraqitet si domosdoshmëri prezantimi i një instrumenti apo mekanizmi që mundëson ndërveprimin dhe koordinimin e masave të të gjitha fushave të veprimit me përqendrim te fëmijët, duke përfshirë jo vetëm sektorët tradicionalë si arsimit, mbrojtja dhe shëndetësia, por edhe argëtimi dhe mjedisi.

REFERENCA:

- 1) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- 2) Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës
- 3) Ligji për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, nr. 18/2017;
- 4) Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet dhe kujdesin shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- 5) Ligj nr. 37/2017, Kodi i drejtësisë penale për të mitur;
- 6) Ligji, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” nr. 10/2021;

- 7) Ligji, "Për të huajt" nr. 108/2013, i ndryshuar;
- 8) Ligji nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore";
- 9) Strategjis kombëtare për të drejtat e fëmijëve 2021-2026
- 10) Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021–2026
- 11) <https://ec.europa.eu/info/laë/better-regulation/have-your-say/initiatives/12454-EU-s-trategy-on-the-rights-of-the-child-2021-24- en>
- 12) <https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CoreInstruments.aspx>
<https://archive.crin.org/en/library/publications/albania-national-laës.html>
https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/TreatyBodyExternal/Treaty.aspx
- 13) [instat_unicef_2021_statistics_publication_en.pdf](#)
- 14) <https://www.unicef.org/albania/documents/four-year-implementation-report-national-agenda-rights-children-2017-2020>